

PLANI STRATEGJIK
RRJETI 23

për periudhën kohore 2015-2020

KODEKSI I MIRËSJELLJES
RRJETI 23

МРЕЖА

23

Shkup, korik 2015

PËRMBAJTA

PARATHËNIE [PLANI STRATEGJIK]

1.HYRJE	5
2.KUSH JEMI DHE PËR ÇKA ANGAZHHEMI	5
3.MISIONI, VIZIONI, VLERAT	6
MISIONI	6
VIZIONI	6
VLERAT	5
4.ANALIZA E KONTEKSTIT	7
5.OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE PRIORITETET 2015-2020	9
OBJEKTIVAT	9
PRIORITETET	9
Fusha GJYQËSORI: KONTRIBUTI I RRJETIT 23 NË DREJTIM TË GJYQËSORIT TË PAVARUR DHE CILËSISË SË DREJTËSISË	9
Fusha PARANDALIMI DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT: KONTRIBUTI I RRJETIT 23 NË DREJTIM TË SIGURIMIT TË SINERGJISË ME RRJETET E TJERAM	9
Fusha TË DREJTAT THEMELORE: KONTRIBUTI I RRJETIT 23 PËR SHKALLË MË TË LARTË TË RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE THEMELORE TË QYTETARËVE	9
MËNYRAT E REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE	10
6.ZBATIMI I PLANIT STRATEGJIK	11
KAPACITETET DHE RESURSET E RRJETIT 23	11
MONITORIMI I ZBATIMIT	11
Ndryshimi/ndikimi	11
Rezultatet	11

PARATHËNIE [KODEKSI I MIRËSJELLJES]

1.Hyrje	12
2.Objektivat dhe target grupet	12
3.Vizioni, misioni dhe vlerat	12
4.Format e bashkëpunimit dhe veprimit të përbashkët	12
5.Anëtarësimi	13
6.Komunikimi	14
7.Dokumente të përbashkëta dhe përfaqësimi	14
8.Ndryshime dhe plotësim	14

Plani Strategjik i RRJETIT 23 është dokument fillestar në procesin e planifikimit strategjik, me të cilin përcaktohet misioni, vizioni, vlerat dhe objektivat strategjike në plan afatmesëm deri në vitin 2020. Strategjia i pasqyron përpjekjet e anëtarëve të RRJETIT 23 për sigurimin e përgjigjes sa i përket regresit të konstatuar në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore në Republikën e Maqedonisë, përmes angazhimit të qartë për zbatimin e standardeve evropiane.

Ky Plan duhet të kontribuojë që RRJETI 23 ta arrijë sinergjinë dhe ta rrit efektin e veprimit të përbashkët të organizatave qytetare në fushat të cilat i mbulon Kapitulli 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore nga anëtarësimi në BE – gjithnjë me qëllim që të forcohet zëri i qytetarëve për domosdoshmërinë e ndryshimeve me qëllim të vendosjes së standardeve të demokracisë dhe sundimit të së drejtës në përditshmërinë maqedonase.

Shoqata e Qytetarëve për Mundësi të Barabarta “Qasje e Barabartë” – Shkup

Shoqata e Punonjësve Financiarë të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjet Publike në Republikën e Maqedonisë - Veles

Shoqata “NOVUS” - Strumicë

Shoqata Sheshi Liria – shoqatë për aktivizëm, teori dhe art - Shkup

Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

Instituti për të Drejtat e Njeriut - Shkup

Koalicioni “Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara” - Shkup

Koalicioni “Të gjithë për Gjykim të Drejtë” - Shkup

OJQ Infoqendra - Shkup

Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësit Mediatik - Shkup

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë - Shkup

Qendra për Strategji dhe Zhvillim “PAKTIS” - Prilep

Qendra për Menaxhimin me Ndryshimet - Shkup

PLANI STRATEGJIK RRJETI 23

1. HYRJE

Rrjeti 23 lindi si rezultat i zbatimit të Projektit „Rrjeti 23“, i financuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit IPA për Mbështetjen e Sektorit Civil. Projekti filloi të zbatohet në muajin maj të vitit 2014. Qëllimi kryesor i Projektit është të kontribuoj në zbatimin e acquis në Kapitullin 23 të procesit aderues të Republikës së Maqedonisë, përmes kontributit të strukturuar të rrjetit të organizatave qytetare.

Njëri nga aktivitetet kryesore të Projektit ishte skema e granteve për mbështetje të organizatave qytetare në nivel nacional dhe lokal, të cilat janë aktive në fushën e sundimit të së drejtës. Skema e granteve kishte për qëllim të krijonjë një platformë monitorimi dhe evaluimi të politikave nacionale në kontekst të zbatimit të standardeve dhe politikave të Kapitullit 23 - Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore.

Duke e perceptuar rolin kyç të Kapitullit në procesin e aderimit, në përputhje me Strategjinë për Zgjerim të BE-së, organizatat qytetare – partnere dhe përfituese të granteve të Projektit iu qasën vetorganizimit të organizatave qytetare.

Plani Strategjik i Rrjetit 23, për periudhën kohore 2015-2020 është produkt i procesit të participimit, përmes punëtorisë kushtuar ndërtimit të Strategjisë dhe Kodeksit të Rrjetit, të mbajtur në Strugë në muajin mars të vitit 2015, si dhe konsultimeve të cilat i paraprinë dhe që pasuan më vonë.

Organizatave – themeluese të Rrjetit 23 e shprehën vullnetin e tyre për vazhdimin e Rrjetit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së tij.

2. KUSH JEMI DHE PËR ÇKA ANGAZHHEMI

Rrjeti 23 përbëhet nga shoqata qytetare, të cilat në aktivitetet e tyre të rregullta i monitorojnë dhe evaluejnë politikave të Kapitullit 23 – Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore dhe i përfaqësojnë qëndrimet dhe propozimet e tyre në këto fusha para autoriteteve publike.

Përmes aktiviteteve të organizatave dhe të Rrjetit bëhen përpjekje në drejtim të stimulimit të debateve publike në Republikën e Maqedonisë për çështje nga fusha e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, të nënvizuara në Kapitullin 23 nga anëtarësimi në BE, të sigurohet ndikim mbi autoritetet publike dhe publikun e gjerë, në bazë të hulumtimit dhe përfaqësimit të bazuar në prova dhe argumente, si dhe të mundësohet që qytetarët ta kenë fjalën e tyre në çështjet kryesore të demokracisë dhe sundimit të së drejtës.

Rrjeti 23 angazhohet për pavarësinë e gjyqësorit dhe sigurimin e cilësisë së drejtësisë. Gjithashtu, Rrjeti 23 angazhohet për zero tolerancë në luftën kundër korrupsionit. Angazhim kryesor i Rrjetit është mbrojtja dhe avancimi i të drejtave themelore të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, në përputhje me Kushtetutën e saj dhe instrumentet juridike ndërkombëtare, veçanërisht Kartën e BE për të Drejtat Themelore dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rrjeti 23, për së afërmi, në mënyrë sistematike do ta monitorojë situatën në Republikën e Maqedonisë në fushat të cilat i përfshin Kapitulli 23 nga anëtarësimi në BE dhe do të angazhohet për përfshirjen e drejtpërdrejtë të Rrjetit në diskutimet dhe debatet midis palëve të interesuara në nivel shtetëror dhe lokal.

Rrjeti 23 në mënyrë aktive do të kontribuojë në monitorimin e realizimit të Programit Nacional për Miratimin e të Drejtës – Kapitulli 23 (Jurisprudenca dhe Të Drejtat Themelore) në kontekst të procesit të anëtarësimit. Rrjeti 23 në mënyrë aktive do t'i monitorojë negociatat për anëtarësim në BE në Kapitullin 23, ndërkaq kur ato do të fillojnë, do ta monitorojë vendosjen dhe përmblidhjen e kritereve për këtë Kapitull dhe do të kontribuojë me qëndrimet, propozimet dhe rekomandimet e veta.

3. MISIONI, VIZIONI, VLERAT

MISIONI

Rrjeti 23 është pjesëmarrës relevant në krijimin dhe monitorimin e politikave të bazuara mbi prova dhe argumente, në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, përmes nxitjes së qytetarisë aktive.

VIZIONI

Maqedonia është anëtare e respektuar e BE në të cilën sundon drejtësia dhe respektohen standardet e larta për të drejtat dhe liritë e njeriut

VLERAT

Në veprimin e tij, Rrjeti 23 fillon nga vlerat e mëposhtme:

*Sundimi i së drejtës

Si parim themelor demokratik, sundimi i së drejtës duhet të mundësojë që askush të mos jetë mbi Ligjin.

*Barazi dhe qasje e barabartë deri te drejtësia

Parimi se të gjithë janë të barabartë para Ligjit dhe të gjithëve u sigurohet qasje e barabartë deri te drejtësia, si vlerë themelore demokratike, është një nga pikat e referimit të veprimit të Rrjetit.

*Transparenca dhe llogaridhënia

Transparenca dhe llogaridhënia e autoriteteve publike duhet të mundësojnë që qytetarët të jenë të informuar për t'i vlerësuar politikatat e autoriteteve dhe për të marrë vendime, e që njëkohësisht do të krijojë kushte që organizatat qytetare në mënyrë reale t'i monitorojnë dhe vlerësojnë politikatat. Gjithashtu, transparenca dhe llogaridhënia e organizatave qytetare mundëson përgjegjësinë e tyre para anëtarësisë së tyre dhe qytetarëve.

*Përgjegjësia

Mosplotësimi dhe shkelja e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara është bazë për përgjegjësi në të gjitha nivelet.

Parimi i përgjegjësisë së autoriteteve publike nënkupton pjesëmarrje aktive të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes politike dhe kontrollit të pushtetit.

*Siguria juridike

Në mënyrë që të sigurohet sundimi i së drejtës, e drejta duhet të jetë e qartë dhe precize, ndërsa pasojat e saj të parashikueshme. Është e domosdoshme që qytetarët dhe të gjitha subjektet juridike të jenë të informuar me të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe të krijojnë kushte në të cilat do të mund të veprojnë, të vetëdijshëm për kushtet dhe pasojat nga veprimet e tyre.

*Dialogu

Dialogu me organet e autoriteteve publike dhe me organizata të tjera, si dhe në kuadër të Rrjetit do të zhvillohet në mënyrë konstruktive, në bazë të argumenteve dhe duke i respektuar argumentet dhe qëndrimet e tjetrit.

*Efikasiteti

Objektivat duhet të realizohen përmes shpenzimit optimal të resurseve, por jo në dëm të procesit demokratik inkluziv.

*Përfshirja

Përfshirja e organizatave qytetare dhe i të gjithë subjekteve të interesuara është bazë për sigurimin e platformës së gjerë për shprehjen e mendimit, qëndrimeve, propozimeve dhe rekomandimeve, me qëllim të pjesëmarrjes në krijimin dhe evaluimin e politikave publike.

*Pjesëmarrja e qytetarëve

Organizatave qytetare duhet të fillojë nga nevoja që në procesin demokratik qytetarët të marrin pjesë në mënyrë thelbësore, të shprehën dhe artikulojnë interesat dhe qëndrimet e tyre, si dhe të respektohen dhe mbrohen të drejtat dhe liritë e tyre.

*Barazia

Përfshirja e të gjitha subjekteve në një proces demokratik mbi baza të njëjta dhe të drejta e detyrime të barabarta është baza e drejtësisë dhe të drejtës.

*Partneriteti

Aksionet e përbashkëta me autoritetet publike, si dhe midis organizatave qytetare bazohen mbi qëllime dhe interesa të përbashkëta, duke e respektuar barazinë dhe të qenit të barabartë, mbi bazë të dialogut konstruktiv, ndërkaq kanë për qëllim përforcimin e zërit të qytetarëve në procesin demokratik.

4. ANALIZA E KONTEKSTIT

Në kohën e miratimit të këtij Plani, Republika e Maqedonisë ballafaqohet me krizë politike dhe institucionale. Ndikimi i vazhdueshëm i pushtetit ekzekutiv mbi organet dhe institucionet e tjera shtetërore çoi në regres sa i përket zhvillimit të standardeve demokratike e që drejtpërsëdrejti ndikoi në realizimin e të drejtave të njeriut. Sa u përket materialeve të regjistruara nga përgjimet, të publikuara nga opozita, të cilat vunë në pah keqpërdorime serioze nga ana e përfaqësuesve të pushtetit dhe partive në pushtet, nuk ka përgjigje përkatëse nga institucionet. Kërkohej zgjidhje politike përmes avancimit të dialogut politik, sigurimit të kushteve për luftë të barabartë politike dhe funksionimit të Parlamentit, në përputhje me rolin e tij kushtetues.¹

Nuk respektohet parimi i ndarjes së pushtetit, ndërsa partitë në pushtet ushtrojnë kontroll mbi institucionet shtetërore. Integriteti i institucioneve është cenuar seriozisht. Ndërhyrja e drejtpërdrejtë e pushtetit ekzekutiv e cenon pavarësinë e gjyqësorit. Përveç kësaj, seriozisht është çrregulluar sistemi i kontrollit dhe ai korrigjues, edhe pse i parashikuar në Kushtetutë dhe ligje. Nuk është siguruar pavarësia funksionale e trupave të pavarura juridike në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore. Lidhja e ngushtë midis partive politike në pushtet dhe institucioneve arrin përmasa të cilat e rrezikojnë rendin juridik të Republikës së Maqedonisë. Niveli i kontrollit të partive në pushtet mbi institucionet shtetërore krijon atmosferën e frikës tek qytetarët.

Hapësira për debat publik është kufizuar. Politikat kryesore dhe ligjet, nga fusha e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, miratohen pa debat transparent, të gjerë dhe konstruktiv të të gjitha palëve të interesuara. Pasiguria juridike në vend paraqet problem për shkak të miratimit të përsheptuar të një numri të madh ligjesh, pa përfshirjen dhe informimin adekuat të palëve të interesuara dhe në përgjithësi të gjitha subjekteve juridike.

¹ Kjo sugjerohet nga ana e një numri të madh të organizatave qytetare vendase dhe raporteve ndërkomëtare në të cilat konstatohet regres në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore.

Gjyqësori

Veçanërisht shqetëson ndikimi i pushtetit ekzekutiv në emërimin, avancimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, si dhe të anëtarëve të trupave dhe institucioneve të pavarura në fushën e jurisprudencës dhe të drejtave të njeriut. Financimi rrjedhës i gjyqësorit nuk i mbulon shpenzimet e jurisprudencës dhe në këtë mënyrë ndikohet mbi pavarësinë e tij, si dhe realizimin e qasjes deri të drejtësia. Praktika gjyqësore nuk është konsistente. Nuk janë krijuar kushte për profesionalizëm dhe paanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.

Stimulimi i theksuar i efikasitetit gjatë miratimit të vendimeve gjyqësore ndikon në cilësinë e aktgjykimeve. Metodot alternative për zgjidhjen e kontesteve, zbatohen pak në praktikë.

Gjykatat dhe prokuroria publike, si dhe institucionet e tjera të jurisprudencës dhe të drejtave themelore nuk janë mjaftueshëm të hapura për publikun.

Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit

Klientelizmi politik punësimi dhe avancimi sipas përkatësisë partiake krijojnë bazë për përhapjen e korrupsionit dhe cenimin e integritetit të të gjitha institucioneve. Ekzistojnë dyshime për keqpërdorim serioz të së drejtës zgjedhore të qytetarëve.

Të drejtat themelore

Analizat e organizatave qytetare – themeluese të Rrjetit 23, konstatuan shkelje të parimit të mbrojtjes nga tortura, trajtimit johuman dhe përcmues, kushtet nëpër burgje janë të këqija, ndërkaq keqpërdoret masa e paraburgimit. Nuk ekziston konsistencë në përcaktimin/matjen e dënimit të kryerësit të veprës penale, si dhe në praktikën e jurisprudencës. Fare nuk përdoren apo përdoren në masë të pamjaftueshme masat alternative të ndëshkimit.

Drastike është rënia e lirisë së shprehjes dhe e mediave, ndërsa gjuha e urrejtjes në të shumtën e rasteve nuk ndëshkohet.

Cenohet e drejta e asociimit të lirë dhe protestave paqësore

Zbulimi i ndjekjes masive të komunikimeve këtë vit vuri në dukje shkëlqimin masiv të të drejtës së privatësisë, keqpërdorimet serioze nga ana e pushtetit dhe dobësitë sistematike institucionale. Zbatimi i deritanishëm i masave të posaçme hetuese dhe marrëveshjes në procedurë penale hapen dilema serioze në lidhje me drejtësinë e procedurës.

Niveli i zbatimit të të drejtave të garantuara procedurale në procedurat gjyqësore nuk i përmbushin standardet evropiane.

Mekanizmat e vendosur për mbrojtje nga diskriminimi nuk funksionojnë në mënyrë adekuate dhe nuk i përmbushin standardet evropiane. Komuniteti LGBT ballafaqohet me dhunë, diskriminim, gjuhë të urrejtjes dhe mbetet pa mbrojtje përkatëse nga ana e shtetit.

Nuk është siguruar konsistencë e masave për realizimin e të drejtave të bashkësive të cilat nuk janë shumicë, në mënyrë që të jetësohen objektivat e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Shënohet regres në barazinë gjinore në nivel të legjislativitetit, politikave dhe praktikave.

Integrimi i romëve, përkrah programeve dhe masave të shumta të deklaruara, është jashtëzakonisht i ngadalshëm.

Mostoleranca ndaj grupeve minoritare dhe të marginalizuara ka karakter institucional dhe çon deri në përjashtimin e tyre.

Qytetarët nuk janë mjaftueshëm të informuar me të drejtat e tyre dhe mënyrat e realizimit të tyre, si dhe me funksionimin e institucioneve.

Nga një shtet, i cili në një periudhë të gjatë tranzicioni, në suaza rajonale, ishte prijës i reformave në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, Republika e Maqedonisë viteve të kaluara u bë shteti me procese retrograde në këto fusha kryesore të demokracisë, gjë të cilën e vënë në dukje një numër i

Ngecja e procesit të aderimit të Republikës së Maqedonisë në BE, para së gjithash për shkak të bllokimit të fillimit të negociatave aderuese, nga ana e Greqisë për shkak të kontestit me emrin, padyshim kishte ndikim të vet mbi gjendjet ekzistuese, për shkak të mungesës së nxitjes së jashtme për reforma. Megjithatë, ruajta e vlerave demokratike të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, para së gjithash dhe mbi të gjitha janë detyrime të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe asgjë nuk guxon ta pengojë mbrojtjen e këtyre vlerave.²

Mosrespektimi i rendit kushtetues dhe ligjeve arrin përmasa të cilat kërkojnë përgjegjësi dhe ndërmarjen e ndërhyrjeve dhe reformave urgjente. Në këtë gjendje, jashtëzakonisht i rëndësishëm është roli i organizatave qytetare – anëtare të Rrjetit 23, të cilat përmes përfshirjes së tyre në monitorimin, vlerësimin dhe përfaqësimin e reformave, mund të kontribuojnë në tejkalimin e sfidave aktuale jashtëzakonisht të vështira.

²Raportet e Komisionit Evropian lidhur me progresin e Republikës së Maqedonisë, nga viti 2011–2014 në kontinuitet vënë në pah regresin e reformave në këtë fushë. Raporti i ekspertëve të Komisionit Evropian, i publikuar në qershor të këtij viti, konstatoi lëshime sistematike në fushën e sundimit të së drejtës në aspekt të keqpërdorimit të kompetencave gjatë ndjekjes së komunikimeve nga ana e DSK.

5.OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE PRIORITETET 2015-2020

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1. RRJETI 23 ËSHTË BURIM RELEVANT I KRIJIMIT TË POLITIKAVE TË BAZUARA MBI ARGUMENTET NË FUSHËN E GJYQËSORIT DHE TË DREJTAVE THEMELORE

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2. RRJETI 23 I PËRFAQËSON ME SUKSES QËNDRIMET E PËRBASHKËTA PARA ORGANEVE KOMPETENTE TË RM-së, NË NIVEL RAJONAL DHE PARA INSTITUCIONEVE TË BE-së

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3. RREJTI 23 KONTRIBUON NË MASË TË KONSIDERUESHME PËR INFORMIMIN E QYTETARËVE DHE NGRITJEN E VETËDIJES PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT

PRIORITETET

Fusha GJYQËSORI: KONTRIBUTI I RRJETIT 23 NDAJ GJYQËSORIT TË PAVARUR DHE CILËSISË SË DREJTËSISË

-zgjedhja dhe avancimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, në bazë të parimit të meritës;

-procedura të paanshme për përgjegjësi dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë;

-financimi dhe administrimi i gjyqësorit për garantimin e pavarësisë së tij;

-pavarësia funksionale dhe integriteti i trupave të pavarur në fushën e gjyqësorit;

-kompetenca dhe paanshmëria e organeve të gjyqësorit;

-përmirësimi i cilësisë së aktgjykimeve;

-procedurë e drejtë gjyqësore;

-sigurimi i qasjes më të mirë deri te drejtësia, përfshirë edhe sistemin e avancuar për ndihmë juridike falas;

-transparencë dhe publicitet në punën e organeve të gjyqësorit;

-krijimi dhe respektimi i praktikës konsekuente gjyqësore dhe publikimi i saj.

Fusha PARANDALIMI DHE LUFTA KUNDËR KORRUPTIONIT: KONTRIBUTI I RRJETIT 23 NË SIGURIMIN E SINERGJISË ME RRJETET E TJERA

-lufta kundër korrupsionit të nivelit të lartë;

-lufta kundër klientelizmit politik;

-pamundësimi i korrupsionit në procesin zgjedhor;

-parandalimi i konfliktit të interesit;

-pavarësia funksionale dhe integriteti i trupave të pavarur në luftën kundër korrupsionit;

-mbrojtja e denoncuesve të korrupsionit.

Fusha TË DREJTAT THEMELORE: KONTRIBUTI I RRJETIT 23 PËR SHKALLËN MË TË LARTË TË RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE THEMELORE TË QYTETARËVE

-realizimi i të drejtës së votimit pa cenime dhe presione;

-respektimi dhe mbrojtja e lirisë së bindjes, ndërgjegjes dhe religjionit;

-respektimi dhe mbrojtja e lirisë së asociimit;

-respektimi dhe mbrojtja e së drejtës së privatësisë dhe kufizimi strikt i ndjekjes së komunikimeve;

-avancimi i lirisë së shprehjes dhe i mediave, përfshirë edhe pluralizmin e mediave;

-ndryshimi i Ligjit për lustrim dhe konsekuencë në ligjshmërinë e zbatimit të procesit;

-respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë;

-përcaktimi i masës paraburgim, në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

-sigurimi i kushteve adekuate të vendosjes në institucionet ndëshkuese-korrektuese (qasje humane, denjësi dhe dinjitet);

-matja e drejtë e lartësisë së dënimeve për kryerësit e veprave penale;

-zbatimi i masave alternative të dënimit;

-zbatimi i mënyrave alternative të zgjidhjes së kontesteve – meditacion dhe arbitrazh;

-respektimi i të drejtave procedurale në procedurat gjyqësore – liri dhe siguri, e drejta për gjykim të drejtë;

-avancimi i të drejtave të fëmijëve;

-avancimi i mbrojtjes të të dhënave personale;

-krijimi i mekanizmave ligjor efektiv dhe institucional për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi;

-avancimi i barazisë gjinore;

-realizimi i të drejtave të bashkësive të cilat nuk janë shumicë;

-programe dhe mekanizma efektivë për integrimin e romëve;

-krijimi i sistemit funksional për mbrojtjen e grupeve vulnerable dhe integrimi i tyre në jetën shoqërore;

-pavarësia funksionale dhe integriteti i trupave të pavarur të cilët veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë;

-avancimi i profesionalizmit në funksionimin e kastës së avokatëve.

MËNYRA E REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE

Rrjeti 23 do t'i realizojë objektivat dhe prioritetet e tij përmes mënyrave të veprimit, si vijon:

-monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave në Kapitullin 23;

-analiza e gjendjeve, ngjarjeve aktuale nga Kapitulli 23;

-nicimi i çështjeve për debat publik;

-përpilimi i raporteve, dokumenteve të politikave me dhënien e rekomandimeve;

-përgatitja e propozimeve për politika publike, për miratimin e ligjeve, dhënien e mendimeve dhe nisma të tjera;

-lobimi i anëtarëve të Rrjetit 23 në krijimin e politikave relevante publike në fushën konkrete;

-përmirësimi i informimit të publikut përmes Rrjetit 23;

-fushata lidhur me çështje të rëndësishme për anëtarët;

-organizimi i debateve publike, konferencave, tryezave të rrumbullakëta dhe diskutimeve të tjera publike;

-reagime të përbashkëta sa u përket ngjarjeve të rëndësishme;

-aktivitete lidhur me përfaqësimin në media;

-konsultime, bashkëpunim dhe aktivitete të përbashkëta me shoqata profesionale dhe me organizata dhe rrjete të tjera qytetare;

-vendosja e bashkëpunimit me asociacione dhe rrjete rajonale dhe ndërkombëtare;

-shfrytëzimi i potencialit dhe dijes së Rrjetit 23 lidhur me qasjen deri te fondet dhe përforsimin e kapaciteteve të anëtarëve; dhe

-forma të tjera të veprimit për të cilat anëtarët e Rrjetit do të bien dakord.

6. ZBATIMI I PLANIT STRATEGJIK

KAPACITETET DHE RESURSET E RRJETIT 23

Rrjeti do t'i përforcojë kapacitetet dhe resurset e veta përmes angazhimit të përbashkët të anëtarëve.

Prioritete në këtë plan do të jenë:

-Përforcimi, zgjerimi dhe disperzimi i Rrjetit 23 në nivel lokal dhe nacional;

-Avancimi i përfaqësimit etnik dhe shumëllojshmëria e organizatave në Rrjetin 23;

-Krijimi i strategjisë për komunikim dhe përfaqësim dhe sigurimi i lidhjes së drejtpërdrejtë me qytetarët;

-Vendosja dhe përforcimi i strukturave dhe mekanizmave të funksionimit të Rrjetit 23;

-Fuqizimi i kapaciteteve hulumtuese të anëtarëve;

-Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhimin organizativ dhe financiar të anëtarëve;

-Fuqizimi i kapaciteteve për monitorimin tematik dhe evaluimin e politikave nga Kapitulli 23, duke e përfshirë edhe zbatimin e Metodologjisë për monitorim dhe evaluim;

-Përgatitja e dokumenteve cilësore për politikak publike;

-Zhvillimi i konceptit të mentorimit, recensionit të brendshëm dhe të jashtëm;

-Shkëmbimi i praktikave më të mira midis anëtarëve, si dhe me organizata të tjera;

-Zhvillimi i bashkëpunimit në nivel rajonal, si dhe me organizata dhe rrjete nga BE.

Rrjeti do ta përdor ueb instrumentin MERC 23 - MK-BE Qendra e resurseve për aktivitetet e veta dhe për aktivitet e anëtarëve. Instrumenti është i hapur për publikun. Anëtarët do të kontribuojnë për azhurnimin e të dhënave në MERC 23.

MONITORIMI MBI ZBATIMIN

Në periudhë afatmesme Rrjeti 23 intervenimet e veta do t'i monitorojë në dy nivele:

1) niveli i rezultateve të arritura (outputs) dhe

2) niveli i ndryshimeve sociale (outcome) edhe atë sipas indikatorëve, si vijojnë:

Ndryshimi/ndikimi

1.Propozimet e Rrjetit merren në konsideratë nga subjektet nacionale në më së paku dy procese të miratimit të vendimeve në nivel vjetor;

2.Qëndrimet e Rrjetit merren në konsideratë nga organizatat ndërkombëtare në më së paku dy raporte në vit;

3.“Raporti vjetor nën hije” është burim relevant për vlerësimin e gjendjeve të publikut më të gjerë;

4.30 % anëtarësi më e madhe dhe më me ndikim deri në vitin 2020; 25% përfshirje të rritur vjetore të qytetarëve në aktivitetet e anëtarëve të Rrjetit;

5.Rrjeti fiton vizibilitet në nivel rajonal në Evropën Juglindore.

Rezultate

Plani Strategjik 2015-2020

1.U përpilua dhe publikua Raporti vjetor nën hije për gjendjet në gjyqësorin dhe të drejtat themelore;

2.Më së paku 2 dokumente të publikuara për politika/rezume të shkurtra të politikave në nivel vjetor;

3.Më së paku 2 hulumtime dhe analiza të përgatitura të të gjithë Rrjetit ose më së paku dy anëtarë bashkë të Rrjetit;

4.Më së paku 3 debate publike të iniciuara (3);

5.25% përfaqësim të rritur në nivel vjetor të Rrjetit 23 në media;

6.Më së paku 2 takime të përbashkëta në nivel vjetor me shoqata profesioniste dhe me organizata qytetare dhe rrjete të tjera.

KODEKSI I MIRËSJELLJES

1. Hyrje

1.1 Kodeksi lindi si rezultat i Projektit “Rrjeti 23”, i financuar nga Bashkimi Evropian, të cilin e zbaton Instituti për Politikë Evropiane (IPE) – Shkup, në partneritet me Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë dhe Qendrën për Menaxhimin e Ndryshimeve. Në kuadër të Projektit u zbatua skema e granteve në të cilën marrin pjesë dhjetë organizata qytetare, të cilat zhvilluan aktivitete në nivel shtetëror dhe lokal.

1.2 Shoqatat qytetare – themeluese të “Rrjetit 23”, e shprehën vullnetin e tyre për vazhdimin e aktiviteteve të Rrjetit. Në këtë kontekst, shoqatat – themeluese ranë dakord ta miratojnë këtë Kodeks të mirësjelljes, me të cilin do të vendosen parimet themelore të përcaktuara me konsensus dhe rregullat e veprimit të Rrjetit.

1.3 Me Kodeksin rregullohen objektivat dhe grupet e interesuara, vizioni dhe misioni, parimet, format e bashkëpunimit dhe veprimit të përbashkët, anëtarësimi në Rrjet, komunikimi, si dhe dokumentet e përbashkëta dhe përfaqësimi në Rrjet.

2. Objektivat dhe target grupet

2.1 Objektivi kryesor i Kodeksit është t'i vendos parimet e bashkëpunimit dhe komunikimit midis anëtarëve të Rrjetit 23, në mënyrë që të mundësojë veprimin e tyre dhe imponimin si faktor relevant në procesin e miratimit të vendimeve dhe politikave publike, në lidhje me fushat e përfshira në Kapitullin 23 të procesit të aderimit në BE – Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore. Target grup i Kodeksit janë shoqatat qytetare të cilat janë aktive në monitorimin, evaluimin dhe përfaqësimin e politikave të cilat kanë të bëjnë me gjyqësorin dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë, punonjësit mediatik, institucionet e larta arsimore, si dhe autoritetet publike në nivel lokal dhe nacional.

3. Vizioni dhe Misioni

3.1 Vizioni i Rrjetit 23 është që Maqedonia të bëhet anëtare e respektuar e BE-së në të cilën sundon ligji dhe respektohen standardet e larta të të drejtave dhe lirive të njeriut.

3.2 Misioni i Rrjetit 23 është të bëhet pjesëmarrëse relevante në krijimin dhe monitorimin e politikave të mbështetura mbi argumentet përmes stimulimit të qytetarisë aktive.

4. Parimet

4.1 Anëtarët e Rrjetit i themelojnë marrëdhëniet e ndërsjella të besimit, e që nënkupton tolerancë, respekt dhe mirëkuptim.

4.2 Anëtarët e Rrjetit e kanë për detyrë të jenë të hapur, të përgjegjshëm, të qartë, llogaridhënës dhe transparentë.

4.3 Anëtarët e Rrjetit janë subjekte të lira dhe të pavarura sa u përket objektivave, vendimeve dhe aktiviteteve të tyre.

4.4 Rrjeti udhëhiqet nga parimi i barazisë së anëtarëve në procesin e miratimit të vendimeve dhe veprimit të përgjithshëm.

4.5 Për përbushjen e vizionit dhe misionit të Rrjetit çdo anëtar i Rrjetit jep kontribut përkatës në punën e Rrjetit.

5. Format e bashkëpunimit dhe veprimt të përbashkët

5.1 Anëtarët e Rrjetit informohen për aktivitetet e përbashkëta të cilat kanë të bëjnë me Rrjetin. Qasja në informata është bazë për të gjitha hapat e mëtutjeshëm për përbushjen e objektivave të Rrjetit.

5.2 Gjatë miratimit të vendimeve, anëtarët konsultohen mes vete. Anëtarët e japin mendimin e tyre për zhvillimin rrjedhës të ngjarjeve dhe kërkojnë komente dhe informata kthyesë. Iniciativat dhe temat shtrohen nga të gjithë anëtarët e Rrjetit, në përputhje me parimin e barazisë.

5.3 Çdo anëtar i Rrjetit ka të drejtë të iniciojë dialog. Dialogu mund të zhvillohet në diskutimet e hapura publike dhe deri në takimet e specializuara midis anëtarëve dhe mund të çojë deri në një analizë të përbashkët, qëndrim, dokument të politikës, rekomandim, mendim, propozim dhe aksion tjetër të përbashkët.

5.4 Veprimi i përbashkët i Rrjetit zhvillohet përmes partneritetit të anëtarëve. Partneriteti nënkupton ndarjen e përgjegjësisë në çdo hap të procesit, nisur nga vendosja e agjendës, formulimi, miratimi i vendimeve dhe zbatimi i iniciativave.

5.5 Çdo anëtar i Rrjetit merr pjesë në ndërtimin e kapaciteteve dhe aftësive të anëtarëve të tjerë, me qëllim që të mund të përfshihen në mënyrë aktive në monitorimin dhe evaluimin e politikave, si dhe sa i përket përfaqësimit. Ndërtimi i kapaciteteve nënkupton transmetim të njohurive dhe praktikave të mira midis anëtarëve të Rrjetit përmes komunikimit të përditshëm.

5.6 Anëtarët e Rrjetit i përfaqësojnë interesat e përbashkëta dhe ngritin çështje për temat të cilat kanë të bëjnë me Kapitullin 23, e që nuk janë përfshirë me legjislacionin ose instrumentet dhe masat e tjera, apo nuk janë përfshirë në mënyrë përkatëse.

Analizat dhe hulumtimet e tyre përbajnë rekomandime të cilat paraqesin zhvillim të zgjidhjeve dhe qasjeve të reja, si dhe angazhohen për përfshirjen e tyre në agjendën politike..

5.7 Anëtarët e Rrjetit kontribuojnë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për politikën e Kapitullit 23 dhe veprojnë me qëllim që të përforcohet zëri i qytetarëve në krijimin dhe vlerësimin e politikave.

5.8 Anëtarët e Rrjetit sigurojnë ekspertizë dhe këshilla për fusha të ndryshme. Në kuadër të Rrjetit përpilohen analiza dhe hulumtime të cilat i identifikojnë nevojat rrjedhëse dhe të ardhshme në shoqëri dhe zhvillohen perspektiva.

5.9 Anëtarët e Rrjetit e monitorojnë procesin e miratimit të vendimeve dhe politikave publike lidhur me Kapitullin 23, me qëllim që të merren parasysh interesat e palëve të interesuara, ndërsa procesi të jetë inkluziv dhe transparent.

5.10 Për realizimin e formave të veprimt të përbashkët, Rrjeti do t'i përdorë instrumentet dhe mekanizmat, si vijojnë:

- data baza MERC, me ç'rast anëtarët e Rrjetit bien dakord që publikimet e tyre të publikohen në këtë ueb-instrument;
- onlajn instrumente si e-peticione;
- diseminimi i afisheve dhe fletëpalosjeve;
- fushata dhe lobime të organizatave qytetare të orientuara kah ndërgjegjësimi i qytetarëve,
- bashkëpunimi me mediat; debate dhe forume publike me grupe të ndryshme për identifikimin e interesave të tyre;
- seminare, trajnime dhe forume qytetare për diskutim me palët e interesuara;
- kontakte personale, etj.

5.11 Rrjeti do të realizojë bashkëpunim me shoqata profesionale, si dhe me institucione relevante të cilat janë aktorë në procesin e miratimit të vendimeve dhe politikave publike në Kapitullin 23.

6. Anëtarësimi

6.1 Qasja dhe anëtarësimi në Rrjetin 23 është vullnetare. Për anëtarësim në Rrjetin 23 nuk paguhet anëtarësi.

6.2 Anëtar i Rrjetit 23, mund të jetë çdo shoqatë qytetare, e regjistruar në Republikën e Maqedonisë, e themeluar më së paku një vit para ditës së aderimit, e cila vepron në fushat e përfshira në Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore dhe në mënyrë aktive mund të kontribuojë në zhvillimin e politikave dhe legjisllacionin nga Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe Të Drejtat Themelore.

6.3 Shoqata, e cila i përbush kushtet për anëtarësim do ta fitojë statusin e anëtarit në Rrjetin 23, pas informimit dhe konsultimit paraprak midis anëtarëve të Rrjetit, me ç'rast është e domosdoshme që më së paku dy të tretat e anëtarëve ekzistues të jenë dakord për aderimin e shoqatës së re.

7. Komunikimi

7.1 Anëtarët e Rrjetit do të takohen më së paku dy herë në vit, në nivel të kryetarëve/drejtorëve, me ç'rast do ta shqyrtojnë zbatimin e këtij Kodeksi dhe Planin Strategjik të Rrjetit, si dhe çështje të tjera të iniciuara nga anëtarët.

7.2 Çdo anëtar i Rrjetit cakton person për komunikim. Komunikimi është kryesisht elektronik, dhe komunikimi i këtitill elektronik, midis personave të cekur për komunikim, konsiderohet si komunikim zyrtar.


7.3 Iniciativa për komunikim mund të vijë nga cilido goftë anëtar i rrjetit. Instituti për Politikë Evropiane (IPE) ka rolin e koordinatorit gjatë komunikimit, përkatësisht detyrë e tij është të sigurojë informim të ndërsjellë të anëtarëve të Rrjetit. Gjithashtu, IPE i ridërgon propozimet e harmonizuara të Rrjetit deri te institucionet kompetente dhe aktorët e tjerë dhe anasjelltas. Vendosija e pikës së përbashkët për kontakt nuk i kufizon shoqatat në realizimin e bashkëpunimit me institucionet kompetente shtetërore.

8. Dokumente të përbashkëta dhe përfaqësimi

8.1 Për publikimin dhe përfaqësimin e dokumenteve të përbashkëta të Rrjetit, anëtarët e Rrjetit bien dakord përmes procesit të konsultimeve. Në mënyrë që një dokument të publikohet dhe promovohet si dokument i Rrjetit, nevojitet që për përmbajtjen e tij të bien dakord më së paku dy të tretat e anëtarëve. Në dokument do të potencohen emërtimet e anëtarëve të cilët janë dakord me përmbajtjen e tij.

9. Ndryshime dhe plotësime

9.1 Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Kodeksi bëhen në përputhje me dy të tretat e anëtarëve, me propozim të një ose më shumë anëtarëve, sipas konsultimit paraprak të të gjithë anëtarëve.



Ky Projekt financohet nga
Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Holandës



Kingdom of the Netherlands